

SHPLLJE PËR PRANIM NË POLICINË BASHKIAKE

Në zbatim të Ligjit nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, neni 14, Bashkia Elbasan bën shpalljen e procedurës për pozicionet e lira:

- **Inspektor i Policisë Bashkiake, Sektori i Shërbimeve në Policinë Bashkiake 1(një) pozicion**
- **Punonjës i Policisë Bashkiake, Sektori i Shërbimeve në Policinë Bashkiake pranë Bashkisë Elbasan 8 (tetë) pozicione**
- **Punonjës i Policisë Bashkiake, Sektori i Ruajtjes së Objekteve në Policinë Bashkiake pranë Bashkisë Elbasan 10 (dhjetë) pozicione**

**Afati për dorëzimin e dokumenteve është 10 (dhjetë) ditë nga dalja e njoftimit:
05.12.2023**

1. KUSHTET DHE KRITERET

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
4. Të ketë përfunduar arsimin e mesëm ose të lartë;
5. Ndaj tij të mos jetë nisur një procedim penal dhe të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtjeje penale;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
7. Të mos jetë larguar nga Policia e Shtetit për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit e Policisë së Shtetit;
8. Të paraqesë vërtetimin e besueshmërisë.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Curriculum Vitae;
2. 2 Foto dokumentash dhe 1 foto 9 X 12 mm;
3. Fotokopje të diplomës së shkollës së mesme ose diplomën bachelor. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njëhësi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
5. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
6. Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
7. Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
8. Dëshmi penaliteti;
9. Vërtetim nga gjykata dhe prokuroria;
10. Vërtetim nga institucioni i punësimit të mëparshëm që nuk ka masë disiplinore në fuqi apo masë disiplinore të largimit nga puna;
11. Vërtetim besueshmërie nga policia;
12. Vërtetim nga Policia e Shtetit që nuk është larguar prej saj me masa disiplinore.
13. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Bashkisë Elbasan, brenda datës 05.12.2023

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **11.12.2023**, Drejtoria e Administratës, Burimeve Njerëzore dhe Monitorimit të Performancës të Bashkisë Elbasan, do të shpallë në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (portali “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”), faqen zyrtare të bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim, testimi fizik dhe intervista nga komisioni përzgjedhës

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, nëpërmjet adresës së tyre të e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET KONKURIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi:

- a) Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- b) Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
- c) Ligjit nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”;
- d) Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Verifikimi paraprak i kandidatit, në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:

1. Komisioni Përzgjedhës, në bazë të dokumentacionit të paraqitur bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kriteret e përcaktuara në ligj dhe në shpalljen për konkurrim.

2. Në përfundim të verifikimit, kandidatët, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Lista shpallet në faqen zyrtare të bashkisë dhe në ambientet e brendshme të saj.
3. Kandidatët, që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim, renditen në një listë të veçantë, në të cilën tregohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Lista administrohet nga njësi e burimeve njerëzore dhe nuk bëhet publike.
4. Kandidatët, që nuk janë kualifikuar, njoftohen individualisht nga njësi e burimeve njerëzore.

Në fazën e parë, kandidatët e kualifikuar do t'i nënshtrohen testimit me shkrim nga Komisioni përkatës i Bashkisë Elbasan. Testimi me shkrim shërben për të vlerësuar nëse kandidati zotëron njohuritë e nevojshme për kryerjen e detyrave të punonjësit të Policisë Bashkiake. Do të shpallen fitues personat që kanë marrë mbi 60% të pikëve të përcaktuara për testimin.

Në fazën e dytë, fituesit e fazës së parë do t'i nënshtrohen testimit të aftësive fizike, që teston aftësitë psikomotore të kandidatit, ku përfshihen shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca dhe koordinimi fizik. Përmbajtja e testimit të aftësive fizike dhe mënyra e vlerësimit të kandidatëve përgatiten nga institucioni arsimor i Policisë së Shtetit, pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike. Kandidati quhet fitues kur ka marrë mbi 60 (gjashtëdhjetë) % të pikëve të përcaktuara për testimin e aftësive fizike.

Kandidatët fitues renditen sipas pikëve të marra në listën e kandidatëve të suksesshëm dhe njoftohen për intervistën.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me formimin dhe aftësitë e tyre, përshtatshmërinë dhe pranueshmërinë për ushtrimin e detyrës. Komisioni i bën kandidatit pyetje të strukturuar, të cilat testojnë formimin dhe aftësitë e tij.

Rezultati i përgjithshëm i kandidatit përcaktohet mbi shumatoren e rezultateve të arritura nga testimi me shkrim, testimi fizik dhe intervista. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen përkatësisht:

- a) testimi me shkrim, 60 (gjashtëdhjetë) pikë;
- b) testimi i aftësive fizike, 20 (njëzet) pikë;
- c) intervista, 20 (njëzet) pikë.

Kandidatët renditen në listën përfundimtare sipas rezultateve të arritura në rend zbritës, sipas pikëve totale të marra.

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Elbasan do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (portali “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”), faqen zyrtare të bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

Kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, nëpërmjet adresës së tyre të e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore të Bashkisë Elbasan, do të shpallë në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (portali “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”), faqen zyrtare të bashkisë dhe në standin e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim, testimi i aftësive fizile dhe intervista e strukturuar me gojë.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe faqen zyrtare të Bashkisë Elbasan, duke filluar nga data **11.12.2023**.

Për më tepër informacion për kushtet dhe mënyrën e zhvillimit të e konkurimit, të interesuarit mund të referohen në Ligjin nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”.